



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 207

Tiranë – E enjte, 30 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 69, datë 13.11.2017	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosëkzekutimit brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 727, datë 14.7.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.....	10825
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 70, datë 13.11.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 2050, datë 17.9.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2037, datë 23.11.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-234, datë 30.3.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	10830
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 71, datë 13.11.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 840 (399), datë 29.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr. 71, datë 1.2.2013 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2016-3203 (584), datë 20.12.2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	10833
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 72, datë 17.11.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. - Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	10839
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 73, datë 17.11.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 6/1, të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”	10842
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 74, datë 17.11.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 403, datë 23.9.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2016-3103, datë 19.12.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	10845



VENDIM

Nr. 69, datë 13.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.10.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 53 Akti, që i përket:

KËRKUES: Petrit Shehu, Zeqir Shehu, Maliq Shehu, Fiqirete Shehu (Gjebrea)

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Qarkut Durrës, Dega e Thesarit Durrës, Shoqëria Përmbartimore “Justitia” Tiranë, Shoqëria Përmbartimore “Petani Bailiff’s Office” Durrës

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 727, datë 14.7.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, që u shprehën për pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Dega e Thesarit Durrës dhe Këshilli i Qarkut Durrës, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, shoqërisë përmbartimore “Justitia” Tiranë dhe “Petani Bailiff’s Service Durrës, që kërkuan pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit janë trashëgimtarë të Ymer Maliq Shehut. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 727, datë 14.7.1999, ka vendosur: *“Detyrimin e të paditurit seksioni i financës pranë Këshillit të Rrethit Durrës t’u kthejë trashëgimtarëve të trashëgimlënësit Ymer Maliq Shehu, napoleona ari 800 ose kundërrlefshën e tyre në lekë.”* Detyrimi total i përlogaritur nga shoqëria përmbartimore për t’iu paguar kërkuësve është 21.801.669 lekë.

2. Në datën 28.5.2013 është lidhur edhe kontrata e shërbimit midis kërkuësve dhe shoqërisë përmbartimore “Petani Bailiff Service” sh.p.k. për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Në datën 23.10.2013 shoqëria përmbartimore ka bërë lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të urdhrin të ekzekutimit nr. 914, datë 26.9.2013.

3. Këshilli i Qarkut Durrës, me shkresën nr. 1443/1, datë 25.10.2013, njofton shoqërinë përmbartimore se ekzekutimin e detyrimit duhet ta kërkojë te Ministria e Financave, e cila ka për detyrë të ekzekutojë vendime gjyqësore që lidhen me sekuestrimin e sendeve personale, bazuar në VKM-në nr. 335, datë 2.6.1998, *“Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”*.

4. Nga ana tjetër, Ministria e Financave, me shkresën nr. 16112/2, datë 25.10.2013, informon kërkuësit se referuar vendimit të gjykatës që duhet të ekzekutohet nuk është Ministria e Financave palë debitore, por Sektori i Financës pranë Këshillit të Qarkut Durrës.

5. Shoqëria përmbartimore “Petani Bailiff’s Service, me shkresën nr. 3026 prot., datë 5.11.2013, i është drejtuar sërish Këshillit të Qarkut Durrës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ky i fundit është përgjigjur me shkresën nr. 1443/3, datë 18.11.2013 se me shkresën e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit të gjitha vendimet gjyqësore duhet të dërgohen pranë Ministrisë së Financave, e cila nga ana e saj ka deklaruar se kthimi i pasurisë së luajtshme, bazuar në ligjin nr. 9235/2004, *“Për kthimin dhe kompensimin e pronave”*, bëhet me ligj të veçantë dhe ky ligj nuk është miratuar ende. Në vijim të këtij qëndrimi, Këshilli i Qarkut ka ngritur padi duke kërkuar konstatimin e



pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, pasi nuk duhej të ishte ai debitori, por Ministria e Financave. Gjykata në përfundim të gjykimit arriti në konkluzionin se ishte Këshilli i Qarkut organi kompetent për të shlyer detyrimin dhe e pushoi çështjen si të pabazuar. Ndaj këtij vendimi nuk u bë ankim.

6. Sërish, shoqëria përmbarimore, me shkresën nr. 499 prot., datë 9.4.2014, i është drejtuar Degës së Thesarit Durrës me urdhër për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e Këshillit të Qarkut. Ky i fundit ka vazhduar të insistojë se nuk është ai që duhet të përgjigjet për kthimin e shumës, por këshilli i rrethit, i cili nuk ekziston më për shkak të riorganizimit të pushtetit vendor. Nuk rezulton që Dega e Thesarit Durrës të ketë marrë ndonjë masë për vendosjen e sekuestros konservative.

7. Shkresat për ekzekutimin e vendimit nga ana e shoqërisë përmbarimore kanë vijuar në datat 26.1.2015, 14.4.2015, 14.9.2015 dhe 11.7.2016, kjo e fundit i është dërguar edhe Ministrisë së Financave.

8. Me shkresën nr. 765/1, datë 12.7.2016, shoqëria përmbarimore i ka dërguar Ministrisë së Financave vendimin për gjobitjen e kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës.

9. Kërkesit, duke mos pasur sukses në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, në datën 25.4.2017 e kanë transferuar çështjen e tyre për ndjekje te një tjetër shoqëri përmbarimore, “Justitia” sh.p.k., e cila, me shkresën nr. 467, datë 25.4.2017, ka urdhëruar Degën e Thesarit Durrës për vendosjen e sekuestros konservative në llogarinë/buxhetin e Këshillit të Qarkut Durrës. Ky i fundit, me shkresën nr. 631/1, datë 8.5.2017, ka kthyer përgjigje se nuk rezulton të ketë asnjë detyrim të dokumentuar ndaj këtyre kreditorëve. Pas komunikimeve të tjera në vazhdim, me qëllim sqarimin e situatës të pretenduar si të panjohur, Këshilli i Qarkut, me shkresën nr. 631/3, datë 24.5.2017, ka deklaruar se ekzekutimi i këtij detyrimi nuk duhet të bëhet nga ky institucion dhe për këtë qëllim ata presin përgjigje nga Ministria e Financave për të vendosur se cili organ duhet të përgjigjet për këtë detyrim. Kjo e fundit, bazuar në shkresën e saj nr. 16112/2, datë 25.10.2013, ka deklaruar se palë debitore në këtë çështje është Këshilli i Rrethit (Qarkut) Durrës dhe jo Ministria e

Financave, gjë e cila është deklaruar edhe me vendim gjyqësor.

10. Deri në marrjen në shqyrtim të kërkesës nga Gjykata rezultoi se shkresa e fundit drejtuar palës debitore, Këshillit të Qarkut Durrës, është nisur nga shoqëria përmbarimore “Justitia” në datën 18.9.2017.

II

11. **Kërkesit** i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Sipas tyre jo vetëm pala debitore, Këshilli i Qarkut Durrës, por edhe shoqëria përmbarimore “Petani Bailiff’s Office” nuk kanë kryer veprimet e duhura sipas ligjit për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë.

12. **Subjektet e interesuara, Këshilli i Qarkut Durrës dhe Dega e Thesarit Durrës**, kanë parashtruar se ato nuk janë debitore as sipas ligjit, as sipas vendimit gjyqësor dhe për këtë arsye nuk kanë detyrim të ekzekutojnë vendimin gjyqësor. Sipas tyre i takon Ministrisë së Financave të bëjë ekzekutimin e detyrimeve monetare që janë vendosur me vendim gjykate.

13. **Subjekti i interesuar, shoqëria përmbarimore “Justitia” Tiranë**, ka parashtruar se prej datës 25.4.2017, kur i është transferuar dosja për ekzekutim të vendimit gjyqësor, ka marrë të gjithë hapat proceduralë të nevojshëm për këtë qëllim, duke i dokumentuar me shkrim të gjitha veprimet përmbarimore që ka kryer. Duke qenë se veprimet e kryera prej tij kanë qenë të pasuksesshme për shkak të mosveprimit të palës debitore, Këshilli i Qarkut Durrës, ai kërkon pranimin e kërkesës.

14. **Subjekti i interesuar, shoqëria përmbarimore “Petani Bailiff’s Service Durrës”** ka parashtruar se nga ana e kësaj shoqërie janë kryer të gjitha procedurat për ekzekutimin e vendimit të gjykatë së formës së prerë. Përgjegjësia për mosekzekutimin e tij nuk duhet kërkuar te kjo shoqëri, por te refuzimi i vazhdueshëm i Këshillit të Qarkut Durrës dhe Ministrisë së Financave për të shlyer detyrimin sipas vendimit gjyqësor.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

15. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkëlur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtët proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të çështjes duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret konstatohet se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë (14.7.1999), deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate (4.7.2017) ka kaluar një periudhë 18-vjeçare. Pavarësisht se kërkuarit kanë filluar veprimet aktive nëpërmjet përmbaruesit në datën 28.5.2013, sërish koha për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë konsiderohet nga Gjykata si një afat i paarsyeshëm dhe i tejzgjatur, ndaj vlerësimi i secilit prej elementeve të lartpërmendura ka rëndësi për çështjen në shqyrtim.

i) Kompleksiteti i çështjes

18. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur një detyrim monetar që duhet t'u paguhet kërkuarëve, që është i përlllogaritur saktë në dispozitivin e vendimit gjyqësor. Për pasojë, Gjykata çmon se çështja nuk paraqet kompleksitet ligjor të veçantë. Në këto kushte, Gjykata thekson se vlerësimi i sjelljes së kërkuarëve dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Sjellja e kërkuarit

19. Kohëzgjatja për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuarit, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

20. Në rastin konkret interesi i kërkuarëve është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e tyre t'iu kthyer pasuria e luajtshme e konfiskuar nga ish-regjimi komunist, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuarit kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ata, nga data e lëshimit të urdhrat ekzekutiv, në 26.9.2013, kanë shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton që me veprimet ose mosveprimet e tyre të jenë bërë shkak apo të kenë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.



21. Konkretisht, në datën 28.5.2013 kërkesit i janë drejtuar shoqërisë përmbarimore “Petani Bailiff Service për ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe mes tyre është lidhur edhe kontrata e shërbimit. Prej këtij momenti ata kanë qenë vazhdimisht në kontakt me shoqërinë e përmbarimit, duke pranuar të bëjnë ose të firmosin çdo shkresë të nevojshme për ekzekutimin e vendimit. Gjithashtu, kërkesit kur kanë konstatuar se shoqëria përmbarimore nuk ka kryer të gjitha veprimet e duhura procedurale për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, kanë vendosur të kontraktojnë një tjetër shoqëri përmbarimore, “Justitia”. Kjo tregon se kërkesit kanë qenë vazhdimisht të interesuar dhe aktivë për të realizuar *de facto* të drejtën e tyre të fituar gjyqësisht.

iii) Sjellja e autoriteteve

22. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 24, datë 22.4.2014; nr. 6, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 6, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa u përket veprimeve të përmbaruesit gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, rezulton se në datën 23.10.2013 shoqëria përmbarimore “Petani Bailiff’s Services, ka bërë

lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të urdhrin të ekzekutimit nr. 914, datë 26.9.2013. Me shkresën nr. 1443/1, datë 25.10.2013, Këshilli i Qarkut Durrës njofton shoqërinë përmbarimore se ekzekutimin e detyrimit duhet ta kërkojë nga Ministria e Financave, e cila ka për detyrë të ekzekutojë vendime gjyqësore që lidhen me sekuestrimin e sendeve personale, duke u bazuar në VKM nr. 335, datë 2.6.1998. Nga ana tjetër, Ministria e Financave, me shkresën nr. 16112/2, datë 25.10.2013, informon se në bazë të vendimit të gjykatës që duhet të ekzekutohet nuk është palë debitorë Ministria e Financave, por Sektori i Financës pranë Këshillit të Qarkut Durrës. Me shkresën nr. 3026 prot., datë 5.11.2013, shoqëria përmbarimore “Petani” i është drejtuar sërish Këshillit të Qarkut Durrës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ky i fundit është përgjigjur me shkresën nr. 1443/3, datë 18.11.2013 se me shkresën e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit të gjitha vendimet gjyqësore duhet të dërgohen pranë Ministrisë së Financave, e cila nga ana e saj ka deklaruar se kthimi i pasurisë së luajtshme, bazuar në ligjin nr. 9235/2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, bëhet me ligj të veçantë, i cili nuk është miratuar ende. Në vijim të këtij qëndrimi, Këshilli i Qarkut ka kërkuar me padi të konstatohet pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, pasi nuk duhej të ishte ai debitori. Gjykata në fund ka konstatuar se ai ishte organi kompetent dhe e ka pushuar çështjen. Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është bërë ankim. Me shkresën nr. 499 prot, datë 9.4.2014, shoqëria përmbarimore “Petani” i është drejtuar Degës së Thesarit Durrës me urdher për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e Këshillit të Qarkut. Ky i fundit ka vazhduar të insistojë se nuk është ai që duhet të përgjigjet për kthimin e shumës, por këshilli i rrethit, i cili nuk ekziston më. Shkresat për ekzekutimin e vendimit nga ana e shoqërisë përmbarimore kanë vijuar në datat 26.1.2015, 14.4.2015, 14.9.2015 dhe 11.7.2016, kjo e fundit i është dërguar edhe Ministrisë së Financave. Me shkresën nr. 765/1, datë 12.7.2016 është dërguar vendimi për gjatitjen e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës, Ministrisë së Financave.

25. Pavarësisht se shoqëria përmbarimore “Petani” pretendon ndryshe, Gjykata konstaton



se nuk janë ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë për ekzekutimin e detyrimit nga ana e palës debitore. Ajo nuk i ka çuar deri në fund disa veprime, siç është rasti i mosndjekjes më tej të kërkesës për sekuestron konservative të llogarisë së palës debitore, si dhe mosekzekutimi i gjobës së vendosur ndaj Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës.

26. Po kështu, rezulton se pala debitore ka refuzuar vazhdimisht duke mos e njohur veten si palë detyruese për të ekzekutuar vendimin gjyqësor, gjë që ka sjellë zvarritje të së drejtës së kërkuesve për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive apo me teknikalitete formale për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Justifikime të tilla si p.sh. këshilli i rrethit Durrës, ndaj të cilit ishte ngritur fillimisht padia, nuk ekziston më për shkak të riorganizimit të pushtetit vendor, ose Dega e Thesarit, organ në varësi të Ministrisë së Financave, nuk mund të kryejë veprime të bazuara në ligj pa dhënë konfirmimin organi epror, megjithëse ky detyrim i rrjedh nga ligji etj., nuk duhet të përdoren me qëllimin e vetëm për t'iu shmangur përmbyshjes së detyrimit që rrjedh nga një vendim gjyqësor i formës së prerë. Gjykata ka theksuar gjithashtu se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet i paekzekutuar dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar veprimeve konkrete dhe sjelljes së debitorit, Gjykata thekson se debitori nuk mund t'i shmangët detyrimin për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë as me veprime që pasjellin zvarritjen e ekzekutimit të

vendimit gjyqësor dhe aq më pak me mosveprim, duke heshtur ndaj një detyrimi ligjor. Ai duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme dhe duhej të gjente mjetin e përshtatshëm ligjor për kryerjen e pagesës, si një detyrim ligjor i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv. Po kështu, edhe shoqëria përmbartimore “Petani” duhet të kishte kryer të gjitha veprimet që parashikon ligji, me qëllim që debitorët të mos shmangen nga detyrimet e tyre ligjore.

28. Duke u nisur nga sa më lart, si dhe nga parashtrimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Qarkut Durrës dhe Degës së Thesarit Durrës, të cilat vazhdojnë të mbajnë qëndrimin se nuk e njohin detyrimin për ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe nuk pranojnë të kryejnë asnjë veprim në përmbyshje të tij, Gjykata arrin në përfundimin se në çështjen në shqyrtim ndodhet para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 727, datë 14.7.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj



VENDIM
Nr. 70, datë 13.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
 e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.10.2017
 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë
 dokumentesh, çështjen me nr. 54 Akti që i përket:

KËRKUES: Ndriçim Balla

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e
 Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me
 Kushtetutën i vendimeve nr. 2050, datë 17.9.2014
 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2037,
 datë 23.11.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.
 00-2017-234, datë 30.3.2017 të Kolegjit Penal të
 Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe
 134/1/i të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë;
 neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e
 Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000,
 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
 Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i
 ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari,
 mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
 kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës,
 prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar,
 Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi pranimin
 pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në
 tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
 vendimin nr. 2050, datë 17.9.2014, ka vendosur:
 “*Deklarimin fajtor të të pandeburit Ndriçim Balla për*
veprën penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese,
prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe
dënimin e tij me 35 vjet burgim.”.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.
2037, datë 23.11.2015 të Gjykatës së Apelit
Tiranë, vendosi: “*Lënien në fuqi të vendimit nr.*
2050, datë 17.9.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Tiranë.”.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me
 vendimin nr. 00-2017-234, datë 30.3.2017, ka
 vendosur: “*Mospranimin e rekursit.*”.

II

4. Kërkuar i është drejtuar Gjykatës
 Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve objekt
 kërkesë me këto pretendime:

4.1 Vendimet e të tria gjykatave nuk kanë
 respektuar standardin e arsytimit të vendimit
 gjyqësor, pasi nuk kanë dhënë përgjigje të
 argumentuar për asnjë nga pretendimet e
 paraqitura në gjykim nga kërkuar. Kjo gjë ka
 cenuar jo vetëm standardin e arsytimit të
 vendimeve, por edhe të drejtën për t’u dëgjuar
 dhe të aksesit gjatë gjykimit.

4.2 Gjykatat kanë cenuar parimin e
 kontradiktoritetit në gjykim, pasi nuk kanë
 pranuar kërkesat e të gjykuarit për të deklaruar si
 të pavlefshme disa nga provat e administruara.
 Gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë disa
 prova dhe dëshmi të paraqitura nga i gjykuari,
 duke i dhënë vlerë provuese vetëm fakteve dhe
 provave të paraqitura nga akuzat. Si rrjedhojë, i
 gjykuari është dënuar mbi bazën e provave të
 marra në kundërshtim me ligjin procedural.
 Shkeljet e gjykatës së shkallë së parë kanë vijuar
 duke zhvilluar gjykimin në mungesë të kërkuarit,
 kur ky i fundit në një seancë ka kërkuar shtyrjen
 e saj për arsye shëndetësore.

4.3 Është cenuar parimi i prezumimit të
 pafajësisë, pasi gjatë gjykimit barra e provës ka
 kaluar padrejtësisht tek i gjykuari dhe jo te pala
 akuzuese, sipas rregullave procedurale, por edhe
 garancive kushtetuese për këtë qëllim.

4.4 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar
 parimin e mosdënimit pa ligj, duke qenë se
 dispozita e Kodit Penal që parashikonte dënimin
 për armëmbajtje pa leje ishte shfuqizuar nga
 Gjykata Kushtetuese dhe ishte miratuar një
 dispozitë e re, e cila parashikonte një dënim më
 të ulët se ai që kishin dhënë gjykatat. Në këto
 kushte, Kolegji Penal duhej të kishte zbatuar
 ligjin penal favorizues.



4.5 Kolegji Penal ka cenuar gjithashtu edhe të drejtën për t'u dëgjuar para gjykatës, si dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs. Shkaqet ku mbështetej rekursi ishin të tilla që duhet të kishin marrë përgjigje në seancë gjyqësore dhe jo në dhomë këshillimi.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka parashtruar se:

5.1 Nuk qëndron pretendimi se është cenuar parimi i barazisë dhe i kontradiktoritetit në gjykim. Kërkuesi ka marrë pjesë në gjykim dhe ka parashtruar kërtime dhe pretendime të cilat kishin të bënin me marrjen e dëshmimeve të disa personave. Gjykatat, pasi i kanë vlerësuar kërkimet, i kanë rrëzuar si të pabazuara në ligj. Kjo nuk e bën procesin të parregullt, pasi një gjë e tillë është në kompetencë dhe vlerësim të gjykatave. Kërkuesi dhe avokati i tij kanë ushtruar të gjitha të drejtat procedurale që i njej ligji.

5.2 Nuk qëndron as pretendimi për cenimin e prezumimit të pafajësisë, pasi kërkuesi nuk ka sjellë asnjë fakt ose provë që gjykimi ndaj tij të ketë filluar me bindjen se ai është fajtor. Asnjë prove të administruar gjatë gjykimit nuk i është dhënë vlerë e paracaktuar, pra është vlerësuar vetëm gjatë gjykimit.

5.3 Nuk është i bazuar as pretendimi se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar. Çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit si filtër seleksionues dhe ai vendim i plotëson të gjitha standardet e arsytimit të vendimit në këtë fazë shqyrtimi, referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese për këtë qëllim.

5.4 I vetmi pretendim i bazuar është ai i lidhur me cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj, pasi Kolegji Penal duhej të kishte marrë parasysh ndryshimet ligjore në Kodin Penal dhe konkretisht të dispozitës e cila favorizonte kërkuesin për akuzën e armëmbajtjes pa leje. Kolegji Penal në këtë mënyrë nuk ka respektuar parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues dhe kërkesa vetëm për këtë pikë duhet të pranohet.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tij janë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe nisur nga ky parim sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Duke qenë se pretendimet e kërkuesit janë të natyrës kushtetuese, Gjykata vlerëson se ai legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtën e pretenduar si të cenuar nga vendimet gjyqësore.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të mosdënimit pa ligj nga Kolegji Penal

8. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke e bazuar vendimin e saj në një dispozitë ligjore që nuk ekziston. Konkretisht, ajo gjykatë nuk ka zbatuar vendimin nr. 9, datë 20.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin janë shfuqizuar pikat 5 dhe 6 të nenit 278 të KP-së, lidhur me masën e dënimit për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Pas këtij vendimi, kjo dispozitë e KP-së është riformuluar nga ligjvënësi dhe masa e dënimit që aplikohet tashmë është më e ulët se



ajo që kanë dhënë gjykatat në përfundim të shqyrtimit të çështjes ndaj kërkuessit. Sipas tij, kjo shkelje e gjykatave më të ulëta duhej të ishte riparuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, si gjykatë rishikuese.

9. Gjykata në jurisprudencë të vazhdueshme ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit të Gjykatës së Lartë të analizojë dhe vlerësojë në dhomë këshillimi nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Neni 432 i KPP-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, kurse neni 433 i po këtij Kodi parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i rekursit vendoset nga Kolegji në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata vëren se ndërkohë që çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, ajo, me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, ka shfuqizuar paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me ligjin nr. 82/2016, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, neni 278 i KP-së është riformuluar, duke e ulur masën e dënimit për këtë veprë. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 151, datë 11.8.2016.

11. Nga materialet e dosjes të çështjes në shqyrtim rezulton se kërkuessi është dënuar nga gjykatat e faktit bazuar në një dispozitë penale që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale prej tij. Gjykata e faktit në vendim, në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, i është përmbajtur ligjit penal në kohën e kryerjes së veprës. Megjithatë, Gjykata konstaton se gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim pranë Kolegjit Penal ndryshoi parashikimi ligjor për masën e dënimit lidhur me një nga veprat penale për të cilën është gjykuar kërkuessi. Për këtë arsye,

Gjykata vlerëson se Kolegji Penal duhej ta kishte marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuessit për cenimin e parimit të ligjit penal favorizues dhe fuqisë prapavepruese të tij, pasi dispozita ligjore penale që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale kishte ndryshuar gjatë kohës së gjykimit të çështjes në këtë gjykatë.

12. Gjykata ka vlerësuar se sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (*lex retro agit in mitius ose lex mitior retro agit*). Ky parim i rëndësishëm kushtetues përmendet shprehimisht edhe në nenin 15/1 të Konventës Ndërkombëtare të OKB-së për të Drejtat Politike e Civile, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 4.1.1992. Duke marrë parasysh rrethanat më lart, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte marrë në konsideratë zbatimin e parimit kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Gjykata vëren se megjithëse është e njohur se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka mënjanuar respektimin e këtij standardi kushtetues. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, duke zhvilluar në këtë mënyrë një proces të parregullt ligjor (*shih vendimet nr. 61, datë 31.7.2017; nr. 27, datë 27.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuessit është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Për pretendimet e tjera

14. Kërkuessi pretendon se gjykatat kanë cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi megjithëse ai kishte paraqitur në rekurs pretendime që kishin të bënin me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij nuk dha përgjigje për asnjë nga pretendimet e natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs. Njëkohësisht, kërkuessi ka pretenduar se Kolegji Penal ka cenuar edhe të drejtën e aksesit në gjykim, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, si p.sh., pretendimit se ai është dënuar mbi bazën e provave të marra në



kundërshtim me ligjin procedural, se gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë disa prova dhe dëshmi të paraqitura nga i gjykuari, duke i dhënë vlerë provuese vetëm fakteve dhe provave të paraqitura nga akuza, gjë që bie ndesh me parimin e kontradiktoritetit, se është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë etj. Sipas kërkesit, të gjitha këto shkelje e kanë bërë procesin të parregullt.

15. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson të mos ndalet në shqyrtimin e tyre, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar dhe në seancë publike pretendimeve të mësipërme të ngritura në rekurs nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 27.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-234, datë 30.3.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
 - Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM Nr. 71, datë 13.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.10.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 44 Akti, që u përket:

KËRKUES: Asqeri Hania, Selim Pipi, Natasha Spiri, Ibrahim Zeneli, Fitnete Zoto, Mariglen Lala, Anastas Mehilli, Veronika Dauti, Eva Brinja, Simo Gerdhuqi, Spiro Kaçi, Miço Vathi, Agron Motra

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pasurive Shtetërore (sot drejtoria e drejtimit të pronës publike) pranë Ministrisë së Financave, ZVRPP-ja Sarandë, Këshilli i Qarkut Vlorë, Valter Lapa, Sokrat Lapa, Kristofor Zeno, Jani Lapa, Izmini Lapa, Mihal Lapa, Piro Lapa

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 840 (399), datë 29.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr. 71, datë 1.2.2013 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër; nr. 00-2016-3203 (584), datë 20.12.2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, familja Lapa dhe Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Me autorizimin nr. 890, datë 8.3.1993 të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (AKP) është autorizuar Seksioni i Financës pranë Këshillit të Rrethit Sarandë të kalojë Oficinën e Riparimit të Automjeteve Sarandë nga pronë shtetërore në pronë private në bashkëpronësi të punonjësve ekzistues.

2. Me kontratën noteriale të shitjes nr. 134 rep., nr. 114 kol., datë 31.1.1994 është kaluar pronësia e objektit Oficina e Riparimit të Automjeteve dhe Reparti Kriko-Dinamo, Sarandë në favor të punonjësve të saj.

3. Në datën 17.2.1994 është nënshkruar kontrata noteriale me nr. 235 rep., nr. 206 kol., datë 17.2.1994, sipas së cilës shitësi, Këshilli i Rrethit Sarandë, u ka shitur kërkuesve (si ish-punonjës) një sipërfaqe prej 5.231 m² që zënë Oficina e Riparimit të Automjeteve dhe Reparti Kriko-Dinamo, Sarandë.

4. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Sarandë, me vendimin nr. 17, datë 9.6.1994, ka vendosur t'u njohë pronësinë e një sipërfaqeje prej 65.500 m² ish-pronarëve Lapa. Në këtë sipërfaqe përfshihen godina banimi, dyqane dhe pjesë nga oficina. Në pikën e dytë të vendimit KKKP-ja është shprehur për kthimin në natyrë të një sipërfaqeje prej 25.000 m², duke përcaktuar kufijtë përkatës.

5. Me vendimin nr. 18, datë 10.6.1994, KKKP-ja Sarandë ka vendosur të njohë pronësinë e Thodhora Zeno mbi një sipërfaqe truall prej 12.300 m². Në pikën e dytë të vendimit KKKP-ja është shprehur për kthimin në natyrë të një sipërfaqeje prej 5.000 m², së bashku me objektet që përfshihen në të, si poligoni i qitjes, pjesë e oficinës së riparimit të automjeteve etj.

6. Ish-pronarët Lapa (subjektet e interesuara) i janë drejtuar gjykatës me padi duke kërkuar, ndër të tjera, konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes së truallit me nr. 235 rep., 206 kol., datë 17.2.1994 dhe kontratës noteriale nr. 134 rep., nr. 114 kol., datë 31.1.1994.

7. Me vendimin nr. 840 (399), datë 29.3.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, fshirjen e pasurive përkatëse nga regjistri hipotekor dhe detyrimin e

Drejtorisë së Administrimit të Pasurive Shtetërore pranë Ministrisë së Financave të bëjë privatizimin e objektit Oficina e Riparimit të Automjeteve, duke zbatuar të drejtën e parablerjes për ish-pronarët.

8. Me vendimin nr. 71, datë 1.3.2013, Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 840 (399), datë 29.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kundër këtij vendimi kërkuesit, pala e paditur në procesin gjyqësor, kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Me vendimin nr. 00-2016-3203, datë 20.12.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 71, datë 1.2.2013 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër.

II

10. **Kërkuesit Asqeri Hania etj.** i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

10.1 *Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si edhe e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.* Sipas kërkuesve në gjykim nuk është formuar drejt ndërgjyqësia për shkak të mosthirrjes të Avokaturës së Shtetit, çka përbën shkelje të rregullave procedurale, konkretisht të nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Në kushtet kur të paditurit, Drejtoria e Administrimit të Pasurive Shtetërore pranë Ministrisë së Financave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, kanë qenë në mungesë, gjykatat duhej të njoftonin Avokaturën e Shtetit të paraqitej në gjykim, sipas nenit 199 të KPC-së.

10.2 *Është cenuar parimi i gjësë së gjykuar dhe parimi i sigurisë juridike,* pasi gjykatat u kanë hequr efektet ligjore vendimeve nr. 106, datë 27.2.1998 dhe nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Sipas kërkuesve, arsyetimi i gjykatave në lidhje me moscenimin e gjësë së gjykuar për sa i përket vendimit nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010 është i gabuar.

10.3 *Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* për shkak se si Gjykata e Apelit ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk kanë marrë parasysh pretendimet e kërkuesve, të cilat kishin të bënin me shkeljen e standardeve kushtetuese për një



proces të rregullt ligjor. Në rastin konkret vendimet gjyqësore nuk rezultojnë të jenë logjike, të rregullta në formë dhe të qarta në përmbajtje. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me faktet dhe legjislacionin në fuqi, pasi kalimi nga pronësia shtetërore në atë private lejohej në kohën e shitblerjes së truallit, bazuar në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”. Vendimet e KKKP-së Sarandë, sipas të cilave subjektet e interesuara janë njohur si ish-pronarë, janë nxjerrë më vonë se sa kontratat e shitblerjes së pronës, ku kërkuesit rezultojnë si pala blerëse, ndaj si të tilla nuk mund të kenë efekte prapavepruese.

11. **Subjektet e interesuar Valter Lapa etj.**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës kanë parashtruar sa vijon:

11.1 Pretendimi se nuk është ndërtuar drejt ndërgjyqësia nuk qëndron, pasi në kuptim të ligjit është e drejtë e palës që vë në lëvizje gjykatën që të përcaktojë se cilat janë palët që do të paraqiten në gjykim. Parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit është zbatuar në gjykim, pasi të gjitha palëve në proces iu janë dhënë të gjitha mundësitë për të paraqitur pretendime në mbrojtje të të drejtave të tyre. Po ashtu, vendimmarrjet e gjykatave në të gjitha shkallët e gjykimit janë bazuar mbi faktet, provat dhe komentet e të gjitha palëve në proces. Në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, vlerësojmë se pjesëmarrja e Avokaturës së Shtetit në gjykim do ta bënte atë të parregullt, pasi secila nga palët private në proces titullin e pronësisë e gëzonte nëpërmjet një akti administrativ shtetëror. Në këto kushte, shteti nuk mund të mbështeste një palë në disfavor të palës tjetër.

11.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në drejtim të gjësë së gjykuar. Referuar vendimit nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010, si në pjesën arsyetuese, ashtu edhe në dispozitiv nuk vërtetohet se ka ekzistuar asnjëherë ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve në gjykim. Në vështrim të këtij vendimi familja Lapa nuk ka qenë pjesëmarrëse në proces dhe ky vendim nuk mund të sjellë pasoja për anëtarët e saj. Ky parim lidhet gjithashtu me objektin e padisë dhe shkakun ligjor, kurse në rastin konkret jemi

përpara kërkimeve me objekt të ndryshëm, bazë të ndryshme ligjore, si dhe me palë të ndryshme. Gjykatat në të tria shkallët e gjykimit i kanë konstatuar absolutisht të pavlefshme kontratat e shitblerjes. Pra jemi para faktit se nuk ka lindur kurrë një e drejtë. Në këto kushte nuk mund të pretendohet për të drejta të cenuara, kur në fakt pala nuk i ka disponuar asnjëherë ato.

11.3 Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ai është i pabazuar, pasi gjykatat kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet dhe provat e palëve në proces, kanë vlerësuar si të drejta dhe ligjore ato të familjes Lapa. Nëse u referohemi vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, ato plotësojnë kërkesat e nenit 142 të Kushtetutës dhe nenit 310 të KPC-së.

12. **Subjekti i interesuar Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave** në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka parashtruar sa vijon:

12.1 Kërkesa është paraqitur jashtë afateve ligjore. Në lidhje me vendimet e gjykatave të faktit, ato janë dhënë në vitet 2012 dhe 2013. Po ashtu, kundërshtimi i këtyre vendimeve nuk është i mundur, për sa kohë që KPC-ja ka parashikuar kundërshtimin e tyre në një shkallë më të lartë, çka nuk është bërë. Për sa i takon vendimit të Kolegjit Administrativ, rezulton se ai është dhënë në datën 20.12.2016, datë në të cilën ka filluar të ecë afati 4-mujor. Kërkesa e parë në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur brenda këtij afati, por ajo nuk ka qenë e plotë dhe të metat e saj janë plotësuar në datën 15 maj, pra pasi kishte kaluar afati 4-mujor për paraqitjen e saj.

12.2 Pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe atij të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara. Në Gjykatën e Lartë çështja është gjykuar në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe ato kanë pasur të drejtën për të paraqitur argumentet mbrojtëse, si dhe për të parashtruar kërkimet e tyre. Ky vendim pasqyron në pjesën hyrëse të gjitha shkaqet e parashtruara në rekurs, si dhe analizon në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimeve e palëve.

12.3 Për sa i takon pretendimit në lidhje me cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, ai është marrë në shqyrtim nga gjykatat e të tria shkallëve



të gjykimit dhe i është dhënë përgjigje. Kërkuessit nuk e kanë ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues.

13. **Subjekti i interesuar Këshilli i Qarkut Vlorë** në shkresën e datës 27.7.2017 është shprehur se vendimet e KKKP-së nuk janë objekt i punës së këtij organi, ndaj nuk ka komente në lidhje me çështjen, kurse *subjekti i interesuar ZVRPP-ja Sarandë* nuk ka paraqitur argumente me shkrim përpara Gjykatës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessve

14. Gjykata vëren se kërkuessit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 71/a, pika 1/b, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuessit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqjesisë, si pasojë e mosthirrjes në gjykim të Avokaturës së Shtetit. Kushtetuta në nenin 134, pika 1/i parashikon individin si subjekt që mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, në kuptim të pikës 2 të po këtij neni, individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si edhe duhet të provojë se në ç’mënyrë ai është cenuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Për sa më sipër, Gjykata vëren se për sa kohë që kërkuessit parashtrajnë pretendime që nuk lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë të së drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor, ata nuk legjitimohen, pasi u mungon interesi vetjak për të ngritur këto pretendime.

16. Po në kuptim të legjitimitimit *ratione materiae* Gjykata vlerëson se pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuessit janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me parimin e gjësë së gjykuar

17. Kërkuessit kanë pretenduar se është cenuar parimi i gjësë së gjykuar, si element i parimit të sigurisë juridike, pasi gjykatat u kanë hequr efektet ligjore vendimeve nr. 106, datë 27.2.1998 dhe nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Sipas kërkuessve, arsyetimi i gjykatave të faktit në lidhje me moscenimin e gjësë së gjykuar, për sa i përket vendimit nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010, është i gabuar. Sipas tyre, gjykatat nuk i kanë marrë parasysh pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk kanë respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi ato nuk rezultojnë të jenë logjike, të rregullta në formë dhe të qarta në përmbajtje. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me faktet dhe legjislacionin në fuqi, pasi kalimi nga pronësia shtetërore në atë private lejohej në kohën e shitblerjes së truallit, bazuar në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”. Vendimet e KKKP-së Sarandë, sipas të cilave subjektet e interesuara janë njohur si ish-pronarë, janë nxjerrë më vonë se sa kontratat e shitblerjes së pronës, ku kërkuessit rezultojnë si pala blerëse, ndaj si të tilla nuk mund të kenë efekte prapavepruese.

18. Konceptet e sigurisë juridike, të të drejtave të fituara, të pritshmërive të ligjshme dhe të besimit të qytetarëve të shteti jurisprudenca kushtetuese i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në gjykimin kushtetues të kërkesave individuale parimi i sigurisë juridike është vlerësuar në harmoni me parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të



gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish në themel të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 27, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenim të vetë sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se vendimi nr. 106, datë 27.2.1998 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka pasur si palë ndërgjyqëse kërkuarit (si paditës) dhe shtetasit R. L., A. L. dhe R. L. (si të paditur), me objekt lirim dhe dorëzimin e objektit “reparti i oficinës”, si dhe shpërblimin e dëmit. Për sa i takon vendimit nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, rezulton se ai ka pasur si palë ndërgjyqëse kërkuarit (si paditës) dhe Drejtorinë e Administrimit të Pasurive Shtetërore pranë Ministrisë së Financave (si të paditur), me objekt detyrimin e paditësve për t’u njohur pronarë, duke vërtetuar qenien e marrëdhënies juridike të krijuar nga kontrata e shitjes nr. 235 rep, nr. 206 kol., datë 17.2.1994.

20. Në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, rezulton se ajo ka si palë ndërgjyqëse subjektet e interesuara Sokrat Lapa dhe Valter Lapa në cilësinë e palës paditëse, kurse si të paditur janë thirrur kërkuarit, si edhe subjektet e interesuara Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pasurive Shtetërore pranë Ministrisë së Financave dhe ZVRPP-ja Sarandë. Objekt i kërkesëpadisë është konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes së truallit me nr. 235 rep., 206 kol., datë 17.2.1994, i kontratës së shitblerjes nr. 134 rep., nr. 114 kol., datë 31.1.1994, konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes së objektit datë 10.8.1993, detyrimi i ZRPP-së Sarandë të fshijë nga regjistri hipotekor kontratën e shitblerjes së truallit, si edhe detyrimi i Drejtorisë së Administrimit të Pasurive Shtetërore pranë Ministrisë së Financave të bëjë privatizimin e objektit Oficina e Riparimit të Automjeteve, duke aplikuar të drejtën e parablerjes për ish-pronarët.

21. Gjykata vëren, gjithashtu, se pretendimi i kërkuarve në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar është ngritur prej tyre në gjykatat e faktit. Në lidhje me këtë pretendim gjykata e shkallës së parë është shprehur: “*Vendimi i sipërcituar (nr. 23-*

2010-1145, datë 22.7.2010) ka vendosur detyrimin e Drejtorisë së Privatizimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave për të njohur ish-punonjësit pronarë duke vërtetuar qenien e marrëdhënies juridike të krijuar me kontratën nr. 235 rep., 206 kol., datë 17.2.1994 (...) Nga analiza e dispozitës së sipërcituar dhe provave të marra në shqyrtim konstatohet se nuk jemi përpara institutit të gjësë së gjykuar. Nga vendimi nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë konstatohet se nuk jemi përpara të njëjtave palë, objekt dhe shkak ligjor” (*shih faqen 17 të vendimit nr. 840 (399), datë 29.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*). Kurse Gjykata e Apelit, po në lidhje me këtë pretendim, është shprehur: “*Referuar të dyja vendimeve të Gjykatës së Rrethit Sarandë, atë me nr. 106, datë 27.2.1998 dhe nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010, në kundërshtim me sa pretendohet në ankësim del se në to nuk janë të njëjtat palë, nuk është i njëjti objekt dhe shkak ligjor” (shih faqen 10 të vendimit nr. 71, datë 1.3.2013 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë)*. Ky pretendim rezulton të jetë ngritur edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë.

22. Gjykata është shprehur se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsytuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu



të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimin nr. 79, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Megjithatë zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërtënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura (*shih vendimin nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke e vlerësuar respektimin e standardeve të mësipërme në kuptim të rrethanave konkrete të kësaj çështje, Gjykata vlerëson se procesi gjyqësor i zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit nuk ngre dyshime në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike. Vendimet gjyqësore nr. 106, datë 27.2.1998 dhe nr. 23-2010-1145, datë 22.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk mund të konsiderohen si gjë e gjykuar, me pasojat që ajo sjell, në procesin gjyqësor të kundërshtuar në këtë gjykim, që lidhet me konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes së truallit të datës 17.2.1994 dhe të kontratës noteriale të datës 31.1.1994.

26. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se pavarësisht faktit se pretendimi i kërkuar për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar nuk ka marrë përgjigje në mënyrë të shprehur në vendimin e Kolegjit Administrativ, ajo, duke e vlerësuar në tërësi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, arrin në përfundimin se kjo nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar atë si të parregullt. Kjo edhe në linjë me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën kushtetuese se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me

Kushtetutë dhe me ligj (*shih vendimin nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka bërë një hetim të plotë për çështjen në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Ai e ka fokusuar kontrollin në drejtëm të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, duke e bazuar vlerësimin e tij mbi provat e administruara në fakt dhe që i janë nënshtuar debatit gjyqësor. Në përfundim të gjykimit Kolegji Administrativ ka dhënë një vendim të arsyetuar në lidhje me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e shprehur në dispozitivin e vendimit.

27. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, lidhur me respektimin e parimit të gjësë së gjykuar, si element i parimit të sigurisë juridike, nuk është i bazuar dhe nuk duhet të pranohet.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuarët Asqeri Hania etj. është e pabazuar dhe ajo duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatos Lulo



VENDIM

Nr. 72, datë 17.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.10.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 43 Akti që i përket:

KËRKUESE: Shoqata “Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë”, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në lirim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Përparim Zano Instituti i Sigurimeve Shoqërore

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1/2, 7, 12, 18, 42, 43, 52/1/2, 124, 131/1/f, 132/1 dhe 134/1/h të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49 dhe 59 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueseve, që kërkuan pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Përparim Zano, që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga dokumentet që shoqërojnë kërkesën rezulton se subjekti i interesuar Përparim Zano ka shërbyer në Forcat e Armatosura deri në daljen e tij në rezervë. Pasi ka përfituar për dy vjet pagën kalimtare, kërkuesi i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Durrës për dhënien e pensionit të parakohshëm. Duke mos qenë dakord me llogaritjen e masës së pensionit, subjekti i interesuar i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 2514 (11-2013-5458), datë 4.11.2013, ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur të anulojë vendimin nr. 25, datë 30.4.2007 lidhur me masën e pensionit, duke e rillogaritur atë në bazë të ligjit nr. 9418, datë 20.5.2005, i ndryshuar. Për 26 vite shërbimi, pagë referuese 46.860 lekë, për 15 vite + $(25-25) \times 2\% = 22\%$. Pagë referuese $46.860 \times 22\% = 33.739$ lekë, duke u aplikuar masa jo më e madhe se katërfishi i pensionit bazë, si dhe indeksimet sipas VKM-së. Detyrimin e palës së paditur t’i kthejë diferencën e krijuar për periudhën 1.9.2006 – 30.6.2009 me masën 583.838 lekë, diferencë kejo e krijuar nga pensioni i dhënë nga pala e paditur me pensionin që i takon sipas ligjit. Pushimin e gjykimit për kërkimet e tjera që i përkasin periudhës nga data 1.7.2009 e në vazhdim.”

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2014-879 (559), datë 14.4.2014, ka vendosur moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Administrative të Apelit.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1784, datë 14.5.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2514 (11-2013-5458), datë 4.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

5. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, kanë vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 1784, datë 14.5.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.”



II

6. Kërkueset, Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë dhe Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në Lirim, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 12.5.2017 për shfuqizimin e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

6.1. Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pasi ka vendosur me nismën e saj të shfuqizojë ligje. Gjykata e Lartë ka vepruar tej kompetencave të veta, duke përcaktuar se cilat ligje duhet të zbatohen dhe cilat jo, madje i ka dhënë fuqi juridike dhe një ligji të shfuqizuar nga ligjvënësi.

6.2 Gjykata e Lartë ka shkelur nenet 124 e vijuese të Kushtetutës, pasi nuk ka bërë unifikim të praktikës gjyqësore, për shkak të interpretimeve të ndryshme të ligjit, por ka bërë vlerësim kushtetues të ligjit.

6.3 Gjykata e Lartë i ka dhënë fuqi prapavepruese vendimit nr. 2/2013 të Gjykatës Kushtetuese për periudhën që ka ekzistuar.

6.4 Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ka cenuar të drejtat e ish-ushtarakëve të fituara dhe garantuara nga ligji, kohë përpara se të merrej ky vendim, duke vendosur që të kthehen përfitime financiare të fituara me ligj dhe me vendime gjyqësore.

6.5 Gjykata e Lartë ka shkelur parimin e hierarkisë së akteve normative dhe nuk ka vendosur në bazë të situatës ligjore e faktike të aplikueshme në kohën e lindjes të së drejtës të pensioneve të parakohshme.

6.6 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi është mjaftuar vetëm me njoftimin e datës së seancës avokatit dhe jo palës paditëse, si dhe e ka zhvilluar procesin gjyqësor pa praninë e saj.

6.7 Gjykata e Lartë ka shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

7. Subjekti i interesuar Përparim Zano pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkueset, është e bazuar dhe duhet pranuar për arsyet e mëposhtme:

7.1 Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi i ka dhënë fuqi prapavepruese nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, në kundërshtim me interpretimin e bërë nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 33, datë 24.6.2010. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se rilogaritja e të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve.

8. Subjekti i interesuar ISSH-ja pretendon se kërkesa nuk përmban asnjë element të cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

8.1 Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë ka unifikuar qëndrimet e ndryshme të gjykatave në lidhje me caktimin e masës së përfitimit të pensioneve suplementare, masë e cila në shumë raste, si rezultat i qëndrimeve të ndryshme gjyqësore, kapërcente edhe pagën që kishte ushtaraku kur qe aktiv.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për pezullimin e vendimit

9. Kërkueset kanë paraqitur në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit unifikues, pasi ekzekutimi i tij do të sjellë pasoja të rënda dhe të pariparueshme për një shtresë shumë të gjerë sociale, siç janë ushtarakët.

10. Gjykata, pasi mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit unifikues, vlerësoi se ajo nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Për rrjedhojë, ajo vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkesëve

11. Gjykata, referuar kërkesës së paraqitur nga kërkueset, vëren se ato i janë drejtuar asaj në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës. Sipas tyre, pavarësisht faktit se kërkesëpadinë për këtë çështje e ka paraqitur në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm subjekti i interesuar Përparim Zano, në bazë të nenit 49/3, shkronjat “d” dhe “e” të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ato legjitimohen për pretendimet e tyre para Gjykatës Kushtetuese.



12. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj se personat juridikë mund të jenë subjekt i të drejtave dhe lirive kushtetuese në nivel të kufizuar “për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve”, në kuptim të nenit 16/2 të Kushtetutës (shih vendimin nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Sipas nenit 131/1/f të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (shih vendimin nr. 28, datë 30.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Neni 131/1/f i Kushtetutës pasqyrohet edhe në përmbajtjen e nenit 49/3, shkronja “e”, të ligjit organik të Gjykatës. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata vëren se kërkueset nuk legjitimohen t'i drejtohen asaj për kundërshtimin e vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Referuar rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor është iniciuar nga subjekti i interesuar Përparim Zano kundër të paditurve DRSSH-ja, Durrës dhe ISSH-ja, Tiranë. Pra, në këtë proces gjyqësor kërkueset nuk kanë qenë palë në gjykim, për rrjedhojë, në kuptim të ankimit kushtetues individual, të drejtën e ankimit për vendimin e kundërshtuar para kësaj Gjykate e kanë vetëm subjektet që kanë qenë palë në proces.

14. Gjykata vëren, gjithashtu, se kërkueset kanë pretenduar se ato legjitimohen edhe në kuptim të nenit 49/3, shkronja “d” të ligjit organik, i cili parashikon organizatat si një ndër subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit ose aktit normativ, në rast se provojnë se akti i kundërshtuar cenon veprimtarinë, të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre.

15. Neni 131/1/c i Kushtetutës parashikon kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën. Po ashtu, neni 116 i Kushtetutës ka përcaktuar se cilat janë aktet normative të cilat kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që mund të bëhen objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë.

16. Duke pasur parasysh se objekti dhe shkaqet e kërkesës mbi të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin e gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se kërkueset kanë kundërshtuar vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, i cili ka unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me mënyrën se si do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 10142 për llogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm për disa kategori funksionesh. Në kushtet kur vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative që parashikon neni 116 i Kushtetutës, në jurisprudencën e saj Gjykata, në raste të tilla, ka vlerësuar se objekt i kërkesës, sipas nenit 131/1/a të Kushtetutës, mund të jetë dispozita. Në rastin konkret, për sa kohë që kërkueset nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesat për legjitimimin e tyre, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nuk mund të bëhet objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë.

17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se për mënyrën se si është paraqitur kjo çështje para saj, kërkueset nuk legjitimohen në kuptim të neneve 131/1, shkronjat “a” dhe “f” të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari



VENDIM
Nr. 73, datë 17.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.9.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 37 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë

SUBJEKTI I INTERESUAR: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 6/1, të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1/dh dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 49 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, që kërkon pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, i cili kërkonte rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, pasi ka konstatuar ndaj shtetasit M.B. kryerjen e kundërvajtjes administrative të transportimit pa leje të 7 m³ lëndë drusore, me vendimin nr. 78, datë 11.7.2016, ka vendosur dënimin në masën 5 000 000 milionë lekë (pesë milionë) gjobë në bazë të ligjit nr. 5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 5/2016). Mbi ankimin

e shtetasit M.B., Komisioni i Ankimit, me vendimin nr. 4642, datë 11.7.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimi nr. 78, datë 11.7.2016 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

2. Në këto kushte, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë është paraqitur për gjykim çështja me palë paditëse shtetasin M.B. dhe palë të paditur Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Korçë, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ nr. 78, datë 11.7.2016 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin e datës 20.3.2017 ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata ka pretenduar shfuqizimin e nenit 6/1 të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

II

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë (në vijim gjykata referuese) në vendimin e saj për pezullimin e çështjes ka parashtruar arsyet e legjitimitetit dhe shkaqet, duke mbështetur pretendimin për shfuqizimin e normës së kundërshtuar.

5. Për shfuqizimin e nenit 6/1 të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se *shkeljet e këtij ligji kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) gjobë*”, gjykata referuese ka argumentuar si vijon:

5.1 Gjykata legjitimohet në kërkesën e saj bazuar në nenet 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës.

5.2 Neni 6/1 i ligjit nr. 5/2016 bie në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimet duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar.

5.3 Sanksioni i parashikuar në ligjin objekt kundërshtimi ka natyrë penale, pavarësisht se nuk parashikohet në dispozitat ligjore penale. Sanksioni i parashikuar është fiks dhe nuk i lë hapësirë vlerësimi organit administrativ apo gjykatës për të përcaktuar rëndësinë e shkeljes në raport me sanksionin.



5.4 Masa e dënimit është joproportionale dhe nuk është e përshtatshme në raport me objektivin që synon të arrihet me këtë ligj.

6. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**, ka paraqitur parashtrime me shkrim duke argumentuar si vijon:

6.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet në kërkesën e saj pasi nuk ka argumentuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitës që kërkohet të shfuqizohet dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Gjykata nuk ka hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen. Shkelja administrative për të cilën është dënuar kërkuesi, konkretisht transportimi i lëndës drusore me qëllim plotësimin e nevojave të popullatës, rregullohet me VKM-në nr. 438, datë 8.6.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore “ dhe jo sipas moratoriumit të pyjeve.

6.2 Gjykata referuese ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor pasi nuk ka arritur të arsyetojë dhe argumentojë papajtueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar me dispozitat kushtetuese.

6.3 Pretendimi i gjykatës referuese se natyra e sanksionit të parashikuar në moratoriumin e pyjeve konsiderohet sanksion penal, pavarësisht se nuk parashikohet në një dispozitë penale, është i pabazuar. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ligjvënësi ka diskrecion dhe është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë. Miratimi i moratoriumit të pyjeve, duke aplikuar ndalimin 10-vjeçar të veprimtarisë, përbën interes publik dhe është i diktuar nga situata faktike dhe proporcionale në raport me të. Në këtë këndvështrim edhe sanksioni i parashikuar është instrumenti ligjor i vetëm për të parandaluar veprimtaritë e parashikuara në nenin 2 të ligjit nr. 5/2016.

6.4 Pretendimi i gjykatës referuese se parashikimi i një sanksioni fiks nuk i lë diskrecion gjykatës për të vlerësuar rëndësinë e shkeljes në varësi të pasojave, është i pabazuar. Ligjvënësi për të përcaktuar sanksionin e shkeljes administrative është bazuar në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, në të cilin parashikohet se masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka përcaktuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me

gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Masa e sanksionit fiks është përcaktuar duke u bazuar në këtë ligj.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

7. Gjykata referuese i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim gjykata) duke pretenduar shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 6/1 të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se *shkeljet e këtij ligji kur nuk përbëjnë veprën penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) gjobë*”.

8. Subjekti i interesuar ka pretenduar se gjykata referuese nuk legjitimohet në kërkimin e saj, pasi nuk ka argumentuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitës që kërkohet të shfuqizohet dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Sipas tij, gjykata referuese nuk ka hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen, pasi shkelja administrative për të cilën është dënuar kërkuesi rregullohet me VKM-në nr. 438, datë 8.6.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore“ dhe jo sipas moratoriumit të pyjeve.

9. Gjykata ka vlerësuar se çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Gjykata rithekson se kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit së gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtari çmon se bie në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrijë arsye



serioze për antikushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës, *së treti* përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimin nr. 39, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 39 datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretuese, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret.

10. Gjikata konstaton se në rastin konkret gjykata referuese ka parashtruar se dispozita objekt gjykimi kushtetuese bie ndesh me nenin 17 të Kushtetutës.

11. Gjikata në jurisprudencën e saj, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, ka çmuar se vendosja me ligj e llojit të dënimeve, ashtu si dhe vetë masa e tyre është diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë bën rregullimin ligjor përkatës. Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive

të individit, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 27.6.2012, nr. 9, datë 26.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit është thelbësore për ligjvënësin të përcaktojë se cilat janë ato veprime të individit që konsiderohen të dënueshme dhe në këtë kuptim nuk i takon Gjykatës të përcaktojë nëse ky vlerësim është mënyra më e përshtatshme, më e arsyeshme ose e duhura, por roli i saj është të kontrollojë nëse përmbajtja e vetë dispozitës është e pajtueshme me të drejtat, liritë dhe parimet themelore kushtetuese (*shih vendimin nr. 55 datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po kështu, Gjikata, në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, ka zberthyer kriteret për të vlerësuar nëse një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit. Këto kriteret janë: i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Lidhur me parashikimin e sanksionit fiks, ligjvënësi për të përcaktuar sanksionin e shkeljes administrative është bazuar në nenin 10 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative", në të cilin parashikohet se masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, që ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Masa e sanksionit fiks është përcaktuar duke u bazuar në këtë ligj.

15. Për sa më sipër, Gjikata çmon se argumentet e gjykatës referuese për joproporcionalitetin e masës së gjobës për kundërvajtjen administrative të parashikuar në ligjin nr. 5/2016, datë 4.2.2016, "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë", nuk janë ngritur në nivelin kushtetues.



16. Gjykata çmon se gjykata referuese nuk ka argumentuar nëse dispozita për të cilën kërkohet shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën është e vetmja që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe ka bërë përpjekje për interpretimin e ligjit në pajtim me Kushtetutën.

17. Në përfundim, Gjykata çmon se gjykata referuese nuk plotëson kriteret për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 6/1 të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/1/dh dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 74, datë 17.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.7.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 36 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Sokol Zhegu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Haxhire Zhegu, Ida Mehmeti, Aleksandri Bregu, Drejtorja e Aluiznit, Tiranë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 403, datë 23.9.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2016-3103, datë 19.12.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar, Drejtorja e ALUIZNI-t, Tiranë, e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Sokol Zhegu i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë me kërkesëpadi me objekt pavlefshmërinë e pjeshme të lejes së legalizimit të lëshuar nga drejtoria rajonale ALUIZNI, Tiranë në emër të subjektit të interesuar Haxhire Zhegu, për pasurinë nr. 7/505, me sipërfaqe 78.24 m², e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380 Tiranë; pavlefshmërinë absolute të kontratës së dhurimit të pasurisë së sipërcituar lidhur mes subjekteve të interesuara Haxhire Zhegu dhe Ida Zhegu; pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes lidhur mes Haxhire Zhegut dhe Ida Zhegut në cilësinë e shitëseve dhe Aleksandër Bregut në cilësinë e blerësit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10205, datë 24.10.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, deklarimin pjesërisht të pavlefshme të lejes së legalizimit dhënë në favor të subjektit të interesuar Haxhire Zhegu, konstatimin pjesërisht të pavlefshme të kontratës së dhurimit dhe të kontratës së shitjes, kthimin e sendit dhe të çmimit të ndërtesës kërkuarit. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër.



3. Mbi ankimin e subjekteve të interesuara Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 403, datë 23.9.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10205, datë 24.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

4. Mbi rekursin e kërkuarit, Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-3103, datë 19.12.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

5. **Kërkuari** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 403, datë 23.9.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 00-2016-3103, datë 19.12.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, me argumentet si vijojnë:

5.1 Gjykata e Apelit Tiranë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore për të shqyrtuar padinë e kërkuarit. Kompetente ka qenë Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pasi objekt kërkesëpadie ka qenë kundërshtimi i aktit administrativ. Kjo gjykatë nuk ka zbatuar ligjin procedural specifik nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

5.2 Gjykata e Apelit Tiranë ka cenuar parimin e paanësisë, pasi është shprehur mbi kërkimet, të cilat nuk ishin ngritur nga palët në proces. Kjo gjykatë ka zbatuar keq ligjin material, pasi ka përcaktuar në mënyrë të gabuar kërkimet e parashtruara në padi, duke i nxjerrë jashtë kontekstit të marrëdhënies objekt gjykimi. Gjykata me nismë të saj ka gjykuar parashkrimin e padisë dhe pse nuk ishte ngritur nga palët, duke marrë rol aktiv.

5.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi duke mos arsyetuar vendimin për mospranimin e rekursit ka cenuar të drejtën e aksesit dhe të barazisë së armëve. Në recurs ishin parashtruar shkaqe të cilat duhet të shqyrtoheshin në seancë plenare.

6. **Subjekti i interesuar Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë** ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

6.1 Drejtoria e ALUIZNI-t ka qenë palë e paditur gjatë procesit civil të zhvilluar dhe çdo kontestim e ka parashtruar gjatë gjykimit. ALUIZNI-i njih si subjekt të së drejtës për

aplikuar për legalizimin e ndërtimit pa leje personin që e ka kryer ose ka investuar, duke e identifikuar me subjektin vetëdeklarues. Në çështjen në shqyrtim objekti është deklaruar për legalizim në vitin 2006 nga subjekti i interesuar Haxhire Zhegu dhe deri në momentin e legalizimit nuk ka pasur ankesa.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, pasi parashikohet si subjekt nga nenet 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae* kërkuari ka parashtruar pretendime të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë hyjnë në juridiksionin kushtetues. Në vijim, Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e kërkuarit.

B. Për themelin e kërkesës

B.1 Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe arsytimit të vendimit gjyqësor

8. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi duke mos arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit ka cenuar të drejtën e aksesit dhe të arsytimit të vendimit gjyqësor. Sipas kërkuarit, në recurs ishin parashtruar shkaqe, të cilat duhet të shqyrtoheshin në seancë plenare.

9. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime, që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 27, datë 27.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Bazuar në nenin 480 të KPC-së, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në recurs janë në përputhje



me kërkesat e ligjit. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminatory të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që çështja të kalojë në seancë publike, por kjo nuk mund t'ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit, për verifikimin nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, nuk është një shkëlqje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 29, datë 19.5.2016; nr. 59, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete nga vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë rezulton se vendimi i mosprimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe asaj të apelit, si dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi, duke pasqyruar dhe shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs, të cilat lidhen me zbatimin dhe respektimin e ligjit material e procedural lidhur me të drejtën e pronësisë, si dhe me përcaktimin e kompetencës lëndore në shqyrtimin e padisë.

12. Në përfundim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është shprehur se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij.

13. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim për shkak të problematikës lidhur me cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi kërkuesi bazuar në objektin e padisë, kundërshtimin e aktit administrativ, ka pretenduar se kompetente për shqyrtimin e çështjes ka qenë Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, si dhe qenies përballë dy vendimeve të ndryshme të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës e Apelit Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në respektim edhe të parimit të subsidiaritetit, duhet të arsyetonte vendimin e tij.

14. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij, i është cenuar jo vetëm e drejta e aksesit dhe e arsytimit të vendimit gjyqësor, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës. (*shih vendimin nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Si përfundim, Gjykata çmon se në çështjen konkrete Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2016-3103, datë 19.12.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë